

Super Porsche
Vetëm për 500 Lekë



ANABEL

[Home](#)
[Sign in with Facebook](#)

Moda	Metropolitan	Bukuria	Shëndeti	Marrëdhënie	Style	Dasma	Q&A	Shkolla & Karriera	Anabel Mama	Horoskopi	Zëra	Market
------	--------------	---------	----------	-------------	-------	-------	-----	--------------------	-------------	-----------	------	--------


Anabel Home: Anabel > Aktualitet

Revolucioni që vjen nga gratë

Simone De Beauvoir, promotrja e debateve feministe në botë dhe një ndër shkrimtaret më të rëndësishme të shekullit të kaluar shtronte pyetje dhe konstatime që akoma sot na duken absurde.

Nga Beti Njuma ~ 2014-06-10 14:41:00

0 Komente



Ngurronte të shkruante për gruan sepse e dinte se subjektet për të ishin acaruese, sidomos për gratë. E megjithatë diskutimet e saj feministe bënë që të rridhte tërë ajo bojë shkrimi aq sa tani kësaj teme pothujase i është vënë pikë. Në traktatet e saj morale dhe filozofike Simone De Beauvoir, promotrja e debateve feministe në botë dhe një ndër shkrimtaret më të rëndësishme të shekullit të kaluar shtronte pyetje dhe konstatime që akoma sot na duken absurde: A ka vërtet gra? Ku janë gratë? Ç'vend zënë ato në këtë botë? Ç'vend do duhet të zënë? Në fund të fundit çfarë është gruaja? Manifesti i saj feminist "Seksi i dytë" i 1949-ës na vinte përpara një pohimi që çdo femër më së paku do ta kundërshtonte se: Çdo qenie njerëzore femër, nuk do të thotë se është patjetër grua.

Tre personazhe, tre histori, tri gra te ndryshme që me përvojat e tyre kërkojnë me çdo kusht të të

LIDHU ME ANABEL



REKLAME



REKLAME



VEESHJA E DITES

The Blonde Salad
Çizme: Givenchy,
Pantallona: J Brand Black,
Pelerina: Louis
Vuitton, Pulovër: Isabel
Marant, Unaza: Caia Jewels,
Çës: Baume et Mercier

faktojnë thënie ekzemplare të krijueses së tyre: grua nuk lind por bëhesh. Edhe në prozën e saj Simone De Beauvoir shfaq forcën e jashtëzakonshme të fjalës dhe shpirtit duke vënë në qendër gruan për të ndërtuar një ideologji të tërë feministe që në fakt sot, me pozitën e lakmuar që ka gruaja në shoqërinë europiane, duket se ka dalë mode. "Gruaja e thyer", në origjinal "La femme rompue" në të vërtetë vjen shumë vonë në shqip po kesh parasysh publikimin e parë në Francë, në vitin 1967 kur shkrimtarja ishte 59 vjeç. Fillimisht libri u prit ftohtë, me snobizëm dhe duke u konsideruar gati gati si një libër rozë, nga ato me "histori grash". Por me sa duket 47 vitet e vonës së përkthimit të një libri janë hiçgjë në një Shqipëri ku nuk ka pasur ndonjëherë lëvizje feministe si ato të Francës së viteve 60-të, e aq më pak ndonjë kryengritje për të thyer heshtjen e tyre ndaj seksualitetit. Në një Shqipëri ku gruaja vritet, dhunohet, fyhet, përçmohet, vuan papunësinë ku konsiderohet ende një shtojcë në jetën e burrave, një objekt për shfryrje epshesh dhe mbarsje, viktimë e paragjytimeve dhe e jetës së izoluar, librat e De Beauvoir janë një arsye e mirë që të botohen dhe të shpërndahen masivisht. Në mos për të bërë ndonjë revolucion (për të cilin ne shqiptarët nuk kemi treguar se kemi këllqe po as shpirt) së paku për të ndezur shkëndijën për reflektim dhe emancipim të brendshëm. Dhe ky është hapi i parë i ndryshimit në shoqërinë ku jetojmë. Një hap që duhet ta hedhin vetë gratë.

Libri "Gruaja e thyer" i sjellë në shqip nga Amantia Kapo ndahet në tri pjesë, tri tregime, secili me protagoniste një grua. Çdonjëra prej tyre përjeton një krizë në një pikë kthese të jetës së vet. Të gjitha mendojnë se janë ndryshe, të gjitha besojnë se disa gjëra nuk mund t'u ndodhin atyre dhe të gjitha e kanë gabim. Një studiuese letërsie tek "Moshë e maturisë" që librat e kanë shpëtuar nga kthetra e trishtimit, një shtëpiake e dëshpëruar tek "Gruaja e thyer" që zbulon se i shoqi e tradhton dhe pas 22 vitesh sheh t'i thërrmohet martesë që e kujtonte të lumtur, dhe një nënë e braktisur në vetminë e saj natën e ndërrimit të viteve dhe e pakënaqur me jetën tek "Monolog".

Monika, Mirielë dhe e ëma e Filipit (emri i saj në tregim nuk shfaqet) janë pariziane me një jetë të lakmueshme. Nuk kanë asgjë të përbashkët veç faktit se ekzistencat e tyre tronditen nga kriza të forta familjare të cilat i thejnë, ashtu siç mund të thyhet diçka e brishtë dhe delikate. Rrëfimi pas të cilit fshihet filozofia e Simone De Beauvoir është i ashpër në sinqeritetin me të cilin përshkruan shoqërinë, duke treguar gjithë ç'mban shpirti i një gruaje e që kurrë s'do guxonte ta shpërfaqte. Jetojmë në shoqërinë e shirjes dhe gënjeshtreve dhe gruaja është viktimë e këtij sistemi dhe mbetet e tillë edhe kur del prej saj.

Në të tre tregimet është vetë gruaja që rrëfen përditshmërinë e saj, zhgënjimet, dhimbjen, idetë, ankthet, që të gjitha bashkë zbulojnë krizën e brendshme, kërkimin e identitetit. Dhe kjo është e vështirë, thuajse e pamundur të ndodhë atëherë kur një grua ka humbur rininë dhe freskinë, dashurinë e dikurshme dhe tanimë jeton moshën e vetmisë së madhe pa pasur rreth saj fëmijët, bashkëshortin dhe gjithçka të bukur që plotësonte ekzistencën e saj. Në këtë pikë ku bashkë me gratë moshohen edhe ndjenjat e tyre është sfillitëse të gjesh forcë për të ecur përpara. A mund të bësh përpara kur ndodhesh në pikën zero, përballë asgjësë?! Në këtë pikë kthjelltësia e De Beauvoir shndërrohet në cinizëm, protagonistja bëhesh ti dhe befas fillon të kesh frikë se mos ndoshta një ditë do të pësosh të njëjtin fat të rëndomtë. Atëherë pëson një nga ato goditjet vetjake pas të cilave të krijohet përshtypja se ky fat na pret të gjithëve. Sidoqoftë ky nuk do të ishte fundi i botës. Gratë e De Beauvoir heqin dorë nga ato që duan por jo nga vetvetja.


Tek e fundit, dera do të hapet ngadalë dhe ato do të shohin çfarë fshihet pas saj. Është e ardhmja. Dera e së ardhmes do të hapet. Ngadalë. E pamëshirshme. Gratë janë veçse tek pragu dhe nuk mund t'i kërkojnë ndihmë askujt.

[VIZITO BLOGUN!](#)


REKLAME



WATCH RIGHT NOW!



Red Bull Thre3Style Albania 2014

Red Bull Thre3Style Albania ishte evenimenti muzikor që elektrizoi Jugun e Shqipërisë fundjavën e kaluar.

BALINABODINAKU

[LEXO TANI NË ANABEL](#)

REKLAME

BLOG
of the DayLori's Blog > [Vizito faqen](#)

Like Share 43  Partager 1  Tweet 0

 Like

Ju këshillojmë të lexoni

North West bën debutimin si modele me Chanel

Beyonce akuzohet sërish për Photoshop

Calvin Harris i kundërpërgjigjet Rita Orës

Pasardhësi i lezetshëm i një zebre e një gomari



Add a comment..

 Also post on Facebook

Posting as Amantia Kapo (Not you?)


[Comment](#)**Mirsida Kujunxhiu** · UNIVERSITETI I TIRANES

Mesazhi i autores i fshehur mes fjaleve te medha...edhe pse librat e de Beauvoir flasin aq qarte dhe thjeshte

[Reply](#) · [Like](#) · [Follow Post](#) · June 12 at 7:17pm

Facebook social plugin

REKLAME

**KASTRATI**
JEWELLERY

Pr. Rbdyl Frashëri, Tirana, Albania

Moda[Personal](#)
[Style](#)
[Style Story](#)
[Fashion](#)
[Obsessed](#)
[Style Guide](#)
[Niko Komani](#)
[Red Carpet](#)**Metropolitan**[Cover Story](#)
[Celebrity](#)
[MetroChic](#)
[Dalina@Anabel](#)
[Ditari i Sabinës](#)
[Alcatraz](#)
[Muzika](#)
[CineMania & TV](#)
[Art & Libra](#)
[High Tech](#)
[Anabel Dossier](#)**Bukuria**[Make-Up](#)
[Flokët](#)
[Lëkura](#)
[Vip Vanity](#)
[Maska për fytyrë dhe flokë](#)**Shëndeti**[Health News](#)
[Shëndeti i Gruas](#)
[Shëndet i Pergjithshem](#)
[Fitness](#)
[Dieta](#)
[Receta te Shëndetshme](#)
[Mendja](#)
[Vetebesimi](#)**Marrëdhënie**[Seks](#)
[Zona ime nga Balina Bodinaku](#)
[Historia Ime](#)
[Dating](#)
[Meshkujt](#)
[Ndarja](#)
[Martesa](#)
[Bashkejetesa](#)**Style**[Tendenca](#)
[Shtepia Ime](#)
[Beje Vete](#)
[Udhetim](#)
[Out and About](#)
[Kuzhina](#)
[Street Style](#)
[VIP style](#)**Dasma**[Nuse](#)
[Ide per Dasmen](#)**Q&A**[Gjinekologe](#)
[Dermatologe](#)
[Pediatre](#)
[Psikologe](#)